



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.561/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Emporium” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, Zona Industriale, NRB 71084329, të cilën e përfaqëson Ruzhdi Kadriu, kundër debitorit “Sh.B. Architect” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Rr. “Abdyl Frashëri” Lam.II/16 pn. NRB 70676044 të cilën e përfaqëson Sh.B. nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, PPP.nr.779/19 dt.28.12.2020, me datën 04.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si e pasafatshme ankesa e kreditorit “Emporium” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, Zona Industriale, NRB 71084329, e parashtruar ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, PPP.nr.779/19 dt.28.12.2020.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.779/19 dt.28.12.2020, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Sh.B. Architect” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.10/19 i datës 03.04.2019, lejuar nga Përmbaruesi Privat Isak Islami, me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovojë në tërësi ankesën e kreditorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.10/19 të datës 03.04.2019.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pasafatshme.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata vërtetoi faktin se kreditori aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë PPP.nr.779/19 dt.28.12.2020, e ka pranuar me datë 27.01.2021 – gjë që vërtetohet nga fletë kthesa e pranuar nga kreditori, dorëzuar përmes Postës.

Ndërkaq, kreditori ankesën ndaj aktvendimit të atakuar e ka parashtruar me datë 05.02.2021, fakt ky i cili vërtetohet nga vula e pranimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e vendosur në ankesë.

Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, pasi që në këtë çështje përmbartimore, sipas Nenit 77 par.2 të LPP afati për ankesë është 7 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit të shkallës së parë me të cilin është vendosur lidhur me çështjen, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh. Meqenëse debitori e ka pranuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me datë 27.01.2021, ndërsa ankesën e ka paraqitur pas skadimit të afatit ligjor shtatë ditor, me datë 05.02.2021 – gjë që vërtetohet nga vula e pranimit të ankesës në Gjykatë. Ndërkaq, kjo Gjykatë vlerësoi se në shkresat e lëndës nuk ka provë apo dëshmi se kreditori e ka dorëzuar ankesën përmes postës, por dërgesa evidentohet vetëm ëprmes vulës së pranimit në Gjykatë.

Në bazë të nenit 186.1 të LPK-së parashihet se ankesa e paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj, ankesën jo të plotë, apo ankesën e palejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore. Ndërsa në bazë të nenit 186.2 të LPK parashihet se ankesa është e pasafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor. Meqë gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh poshtë si të pasafatshme ankesën e debitorit, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, në bazë të nenit 196 të LPK-së e ka hedhë poshtë ankesën si të palejueshme

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit dhe atë në bazë të nenit 195.1 pika a), lidhur me nenin 196 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.561/23, me datë 04.11.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova